

VENDIM
Nr. 830, datë 23.11.2016

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 1068, DATË 23.12.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT
“KATUNDI I RI” MBI LUMIN DRINI I ZI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 25, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 1068, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për ndërtimin e hidrocentralit “Katundi i Ri” mbi lumin Drini i Zi”.
 2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama